# TRANSPARENCA DHE PËRGJEGJËSIA NË NIVEL VENDOR

# VLERËSIMI I PROCESEVE TË KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË VAU I DEJËS

# 2024

PËRGATITUR NGA:

QENDRA "HAPA TË LEHTË"

RRJETI PËRBALLJA E OFERTAVE POLITIKE

# Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik

Bashkia Vau i Dejës

Përgatiti: Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë"

*Korrik 2024*

# Tabela e Përmbajtjes

TABELA E PËRMBAJTJES ....2
1. LISTA E SHKURTIMEVE ....3
2. HYRJE....4
3. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E STUDIMIT ....6
4. METODOLOGJIA E STUDIMIT ....7
5. KUADRI LIGJOR NË NIVEL VENDOR ....9
6. PËRSHKRIMI I STRUKTURËS SË QEVERISJES LOKALE NË BASHKINË VAU I DEJËS ....10
7. HISTORIKU I PROCESIT TË NJOFTIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK NË BASHKINË VAU I DEJËS ....14
8. VLERËSIM I EFEKTIVITETIT DHE TRANSPARENCËS SË PROCESIT TË KONSULTIMIT PUBLIK ....16
8.1 GJETJE NGA INTERVISTAT E REALIZUARA ME STAF TË BASHKISË VAU I DEJËS DHE ANËTARË TË KËSHILLIT BASHKIAK PRANË KËSAJ BASHKIE ....21
9. PËRMBLEDHJE E KOMENTEVE DHE REKOMANDIMEVE TË GRUPEVE TË INTERESIT E QYTETARËVE NGA KONSULTIMI PUBLIK ....26
9.1 INTERVISTAT E THELLUARA ME GRUPET E INTERESIT ....27
9.2 PERCEPTIMET E QYTETARËVE PËRMES VLERËSIMIT ONLINE. ....30
10. KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME....33
11. REFERENCA (LISTA E BURIMEVE TË PËRDORURA PËR STUDIMIN) ....34
12. ANEKSE ....35

# 1. Lista e Shkurtimeve

| | |
|---|---|
| **AMVV** | Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore |
| **BP** | Buxhetimi me Pjesëmarrje |
| **KB** | Këshilli Bashkiak |
| **KDIMDP** | Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale |
| **KLSH** | Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| **NED** | National Endowment for Democracy |
| **Nj.A** | Njësi Administrative |
| **NJVQV** | Njësi e Vetëqeverisjes Vendore |
| **OPIC** | Olof Palme International Center |
| **OSHC** | Organizatë e Shoqërisë Civile |
| **PBA** | Projekt Buxheti Afatëmesëm |
| **POP** | Përballja e Ofertave Politike |
| **VKB** | Vendim i Këshillit Bashkiak |
| **QGHL** | Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë" |

## 2. Hyrje

Angazhimi dhe përfshirja e qytetarëve në konsultim dhe vendimmarrje përbën një nga elementët kryesorë drejt zhvillimit të qëndrueshëm dhe qeverisjes së mirë, ku zëri i të gjithëve dëgjohet gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose përmes organizatave të shoqërisë civile tek institucionet përgjegjëse. Pjesëmarrja aktive e qytetarëve garanton identifikimin e problemeve dhe nevojave reale, përfshirjen e njohurive dhe përvojave të të gjithë aktorëve, duke i bërë ata të ndihen përgjegjës për çështje të përbashkëta, duke rritur besueshmërinë dhe transparencën për krijimin e mundësive për zgjidhje të qëndrueshme.

Roli dhe kontributi i pazëvendësueshëm i qytetarëve dhe komuniteteve në proceset qeverisëse është kyç për arritjen e një qeverisjeje sa më demokratike, ndërkohë që bashkitë përmes zbatimit efektiv të ligjit dhe politikave të duhura e gjithëpërfshirëse sigurojnë zhvillim të qëndrueshëm, përfshirje dhe kohezion social.

Është misioni i qeverisjes vendore të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve të saj dhe të nxisë pjesëmarrjen e tyre efektive në të, ndërkohë që ushtrimi i qeverisjes dhe përmirësimi i cilësisë së jetës nuk mund dhe nuk duhet të jenë e drejtë ekskluzive e saj. Për sa kohë që ekzistojnë mekanizma dhe modele të mirëqeverisjes, bashkitë duhet të vijojnë të kërkojnë, adaptojnë e praktikojnë alternativa dhe forma ku qytetarët, grupet e interest dhe shoqëria civile shihen si partnerë të domosdoshëm të këtij procesi.

Studimi "Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik" zhvillohet në kuadër të vlerësimit të situatës ekzistuese në lidhje me praktikat e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor. Ai zhvillohet nga Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike"[1] (POP) në kuadër të projektit "Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike" financuar nga National Endowment for Democracy dhe Olof Palme International Center.

Rrjeti POP përmes këtij programi synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë bashkiakë.

Organizatat anëtare të Rrjetit POP, veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë e tyre vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikat dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Nën këtë optikë në periudhën Maj – Qershor 2024, është realizuar studimi "Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor - Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik". Studimi ka për qëllim të vlerësojë situatën në 10 bashkitë e targetuara[2] për periudhën Shtator 2023 – Maj 2024, për të pasqyruar situatën e realizimit të njoftimit dhe konsultimit publik në këto njësi të qeverisjes vendore. Gjetjet dhe rekomandimet do të shërbejnë për të marrë një informacion më të thelluar për mekanizmat e identifikuar të Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit në nivel vendor, sfidat, vështirësitë dhe rastet e suksesit në zbatimin e tij. Rrjeti POP në një fazë të mëvonshme do të punojë dhe me institucionet mbikqyrëse për të ndarë gjetjet e studimit, siç

[1] Faqe zyrtare e Rrjetit POP: https://popnetwork.al/

[2] Tiranë, Durrës, Vlorë, Pukë, Elbasan, Fier, Kukës, Shkodër, Vau i Dejës, Korçë

janë Prefekturat, Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale si dhe Kontrollin e Lartë të Shtetit.

*Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "National Endowment for Democracy."*

**Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:**

| | |
|---|---|
| • ***Qendra "Aleanca Gjinore për Zhvillim", Tiranë;***<br>• ***Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;***<br>• ***Qendra Rinore Vlorë,***<br>• ***Epoka e Re, Fier;*** | • ***Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;***<br>• ***Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;***<br>• ***Qendra për Progres Rinor, Kukës,***<br>• ***Gruaja në Zhvillim, Korçë;***<br>• ***Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;***<br>• ***Tjetër Vizion, Elbasan*** |

## 3. Përmbledhje Ekzekutive e Studimit

Përgatitja e këtij raporti është bërë nga Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike" në kuadër të projektit "Nxitja e Mbikëqyrjes Qytetare mbi Përgjegjshmërinë Politike" financuar nga National Endowment for Democracy dhe Olof Palme International Center. Rrjeti POP përmes këtij programi synon të përmirësojë qeverisjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike, si dhe mbrojtjes efektive të të drejtave të njeriut, nëpërmjet forcimit të kapaciteteve të OSHC-ve për të ndikuar në proceset e politikave të përfaqësuesve të tyre vendorë bashkiakë.

Vau Dejës, studimi është përgatitur nga Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë"[3], (organizatë anëtare e Rrjetit POP), me synimin kryesor që organizatat lokale të veprojnë si grupe presioni për të advokuar në qeveritë e tyre vendore për të identifikuar prioritetet e zhvillimit, në mënyrë që politikat dhe programet të bazohen në nevojat lokale, si dhe në mundësitë dhe kapacitetet e disponueshme.

Studimi "Transparenca dhe Përgjegjësia në Nivel Vendor – Vlerësimi i Proceseve të Konsultimit Publik në Vau Dejës" vlerësoi situatën e realizimit të Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik për periudhën Shtator 2023 – Maj 2024, përmes monitorimit të dëgjesave publike duke nxitur diskutimin midis aktorëve të përfshirë për njohjen dhe zbatimin e ligjit, si dhe përgatiti disa rekomandime konkrete në nivel të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore (NjVQV)

Pjesëmarrja e drejtpërdrejtë në vendimmarrje përfaqëson një nga format kryesore të angazhimit të qytetarëve në jetën publike. Kjo arrihet përmes mjeteve dhe mekanizmave që NJVQV ushtrojnë, në përputhje me Ligjin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik[4] duke vënë në dispozicion të qytetarëve, hapësira dhe mundësi për t'i përfshirë ata në formulimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave, programeve dhe shërbimeve për komunitetin. Pavarësisht se të gjithë të intervistuarit e vlerësonin rëndësinë e proceseve konsultuese dhe gjithëpërfshirëse, realizimi efektiv i tyre në nivel vendor mbetet ende një sfidë.

**Gjetjet Kryesore**

Nga analizimi i procesit të konsultimit publik dhe transparencës në Bashkinë Vau Dejës, janë identifikuar disa gjetje dhe mundësi për përmirësim:

- Aktualisht në Bashkinë Vau Dejës nuk ka një pozicion në organikën e kësaj Bashkie për koordinimin e procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik.
- Këshilli Bashkiak që prej vitit 2021 ka krijuar një Rregjistër Elektronik të Projektakteve për Konsultim Publik, i cili ka projektaktet dhe dokumentet e tjerë që janë në proces konsultimi. Ky sistem ofron akses për qytetarët për të ndjekur dhe kontribuar në proceset e konsultimit.
- Që prej vitit 2022 e në vazhdim Këshilli Bashkiak ka të publikuar buxhetin e tij në website, po kështu në vitin 2024 Këshilli Bashkiak ka publikuar për herë të parë Raportin vjetor mbi punën e Këshillit për vitin 2023. Konstatohet se, për herë të parë Këshilli Bashkiak ka hartuar një pyetësor në lidhje me prioritetet e Buxhetit për vitin 2024 dhe për herë të parë ka publikuar monitorimin e programit të transparencës.

---

[3] Faqe zyrtare e QGHL: https://hapatelehte.org/?lang=en

[4] Ligji per NJoftimin dhe Konsultimin Publik: https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e

- Bashkia Vau Dejës përdor disa nga mjete për realizimin e Njoftimeve për Konsultimet publike por nuk i përdor të gjitha mjetet apo metodat e parashikuara në ligj. Ajo publikon njoftimet për konsultimet publike, realizon njoftimet nëpërmjet disa kanaleve, por ka nevojë për zhvillimin e kanaleve dhe metodave të reja të komunikimit për të rritur përfshirjen e qytetarëve dhe për ti bërë proceset e Konsultimit Publik më transparente dhe të ndikueshme.
- Nuk ka një regjistër të qartë dhe të përditësuar për pjesëmarrjen e qytetarëve në konsultimet publike dhe format aktuale të komunikimit nuk janë të mjaftueshme për të inkurajuar pjesëmarrje të gjerë.
- Programi i Transparencës në Bashkinë Vau Dejës është miratuar së fundmi me dt.20.03.2024
- Konstatojmë që projektvendimet nuk shoqërohen gjithmonë me përmbledhje të rekomandimeve të marra gjatë procesit të konsultimit.
- Njohuritë mbi Ligjin për Konsultimin Publik janë të kufizuara, sidomos në mesin e të rinjve dhe qytetarëve të tjerë që jetojnë në njësi administrative. Sugjerohet që Bashkia të përdorë disa mjete inovative për përfshirjen e të rinjve në këto procese duke i dhënë edhe rol të caktuar Këshillit Vendor Rinor që tashmë e ka ngritur me qëllim nxitjen e të rinjve për t'u përfshirë në këto procese.

## 4. Metodologjia e Studimit

Për përgatitjen e vlerësimit në lidhje me zbatimin e Ligjit të Njoftimit dhe Konsultimit publik (ligji nr. 146/2014[5]) në bashkinë Vau Dejës, ekspertët e projektit kombinuan një sërë mjetesh dhe metodologjish duke përfshirë:

- Analizimin e Gjetjeve të Raportit Studimor "Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik" realizuar nga Rrjeti POP në vitin 2022.[6]
- Rishikimin e dokumenteve strategjikë, publikimet në regjistrin elektronik për konsultimet, publikimet në programin e transparencës, raporte të prodhuara dhe bazat e të dhënave në të gjitha fazat mbi procesin e njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor;
- Hulumtimi i raporteve dhe mekanizmave të kontrollit të Prefekturës përkatëse; Kontrollit të Lartë të Shtetit si edhe të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (KDIMDP) për monitorimin e zbatimit të ligjit të njoftimit dhe konsultimit publik në nivel vendor.
- Kërkesa zyrtare për informacion drejtuar Kryetarit të bashkisë.
- Përgatitjen e pyetësorëve të studimit; trajnimin e intervistuesve; 5 intervista të drejtpërdrejta me stafin e bashkisë si edhe 5 intervista të thelluara me anëtarë të këshillave bashkiakë. 25 (16F/9M) intervista të thelluara me aktivistë/përfaqësues të komunitetit dhe qytetarë (10 intervista me OJF, Biznese, aktiviste të shoqerisë civile dhe 15 të tjera me qytetarë nga grupet e interesit); 124 (84F/40M) pyetësorë online si

---

[5] Ligji per NJoftimin dhe Konsultimin Publik: https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e

[6] Raporti Studimor përgatitur nga Qendra Sociale "Hapa të Lehtë" 2022: https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-vau-i-dejes/

edhe përpunimin dhe analizimin e të dhënave dhe përgatitjen e raportit përfundimtar të studimit.

Burimi kryesor i informacionit në lidhje me shqyrtimin e dokumenteve strategjikë, raporteve të prodhuara dhe zbatimit të fazave të procesit të njoftimit dhe konsultimit publik janë faqet zyrtare të internetit të bashkisë e këshillit bashkiak të përzgjedhura në studim, rregulloret e brendshme, publikimi i njoftimeve dhe dokumentacionit lidhur me konsultimet publike të zhvilluara, por edhe raportet e prodhuara nga institucione ndërkombëtare apo organizata të shoqërisë civile.

Në lidhje me mekanizmat e kontrollit të zbatimit të ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik, ekspertët dhe organizatat e përfshira në projekt kanë hulumtuar dokumentet e prodhuara nga institucionet që monitorojnë drejtëpërdrejtë zbatimin e ligjit për Njoftimin dhe Konsultimit Publik si institucioni i Prefektit, Kontrolli i Lartë i Shtetit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të dhënave Personale.

Për përgatitjen e studimit ekspertët e projektit hartuan kërkesa për informacion drejtuar kryetarit të bashkisë e stafeve bashkiakë të NjVQV, pyetësorë dhe intervista të thelluara me koordinatorin e njoftimit dhe konsultimit publik, sekretariatin e këshillit bashkiakë dhe aktivistë, qytetarë e përfaqësues të OSHC-ve. Pyetësorët përmbajnë pyetje rreth temave që lidhen me: urdhërat e brendshëm për fillimin e procedurës së konsultimit publik; përgatitja dhe publikimi i kalendarit të konsultimit publik; njoftimi i konsultimit publik; realizimi i konsultimit; përgatitja dhe publikimi i procesverbaleve, ndikimi i rekomandimeve të qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimet përfundimtare të aprovuara nga vendimarrësit si dhe publikimi i raportit të konsultimit publik në rregjistrin elektronik. Në lidhje me qytetarët dhe grupet e interesit përmes pyetësorëve është vlerësuar efektiviteti i procesit të konsultimit publik, si reflektohen rekomandimet e tyre dhe si ndikon në jetën e qytetarëve vendimet që nuk konsultohen me procest pjesëmarrëse.

Pyetësorët e shpërndarë përmbajnë pyetje cilësore dhe sasiore duke mbajtur në vëmendje ekspertizën lokale të organizatave të rrjetit POP, në cështje të qeverisjes vendore dhe angazhimit qytetar. Për përgatitjen e pyetësorve ekspertët e organizatve lokale konsideruan faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në cilësinë e sondazhit, të tilla si: objektivi i përgjithshëm i anketimit dhe konteksti lokal (të dhënat informacionet ekzistuese) për të mundësuar një kuptim më të mirë të situatës dhe çështjeve.

Gjithashtu u trajnuan 10 përfaqësues të organizatave dhe bisneseve lokalë, për të zhvilluar intervistat në terren. Intervistat kërkuan të sigurojnë marrjen e informacioneve në aspektin gjeografik, të moshës dhe gjinisë. Intervistuesit zhvilluan intervista të drejtpërdrejta, duke drejtuar pyetjet personalisht dhe duke plotësuar në vend pyetësorët.

Pas përfundimit të intervistave u zhvillua një bazë të dhënash, për t'u përpunuar dhe analizuar. Qendra Rinore e Vlorës përgatiti një raport të hollësishëm të vëzhgimit me gjetjet dhe rekomandimet që do të përdoren në një fazë të mëvonshme për të avokuar për nevojat dhe prioritetet qytetarëve me përfaqësues të institucioneve vendore (Bashkia dhe KB).

Ky raport studimor është një kontribut i rëndësishëm për të kuptuar dhe përmirësuar mënyrat e përfshirjes së qytetarëve në vendimmarrjen publike, duke synuar një qeverisje më të hapur, transparente dhe të përgjegjshme në Bashkinë Vau Dejës.

Një raport i përbashkët me gjetjet nga 10 bashkitë: Tiranë; Durrës; Elbasan; Vlorë; Fier; Vau Dejës; Korçë; Pukë; Kukës; Shkodër do të hartohet me metodën krahasuese dhe do të shërbejë për të evidentuar progresin e arritur duke analizuar të dhënat e grumbulluara nga gjetjet, konkluzionet dhe rekomandimet e arritura nga raporte të mëparshme duke përdorur indikatorë sasiorë dhe cilësore si burime primare [7] dhe sekondare [8] për grumbullimin e informacionit.

Gjetjet dhe rekomandimet e raportit do të synojnë përmirësimin e situatës aktuale nëpërmjet masave që autoritetet vendore duhet të ndërmarrin në lidhje me zbatimin e ligjit dhe propozime për ndryshime ligjore për ta bërë procesin sa më interaktiv dhe gjithëpërfshirës.

## 5. Kuadri ligjor në nivel vendor

Misioni i NJVQV është të sigurojë një administrim sa më pranë qytetarëve dhe të nxisin një pjesëmarrje efektive të banorëve në qeverisjen vendore. Transparenca, llogaridhënia dhe përfshirja publike janë parimet themelore për ruajtjen dhe avancimin e demokracisë.

Dialogu ndërmjet qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur, si dhe përfshirja e tyre në qeverisjen lokale, janë thelbësore për avancimin e demokracisë lokale, sepse forcohet legjitimiteti dhe efektiviteti i veprimeve të bashkisë dhe këshillit bashkiak. Procesi i konsultimit publik përbën një shtyllë kryesore për një qeverisje transparente, duke i mundësuar qytetarëve dhe grupeve të interesit diskutimin, dialogun, monitorimin dhe vlerësimin e punës së pushtetit vendor.

Në vëmendje të këtij studimi është njohja dhe zbatimi në bashkinë Vau Dejës i Ligjit Nr. 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik" dhe Ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" që detyrojnë organet e vetëqeverisjes vendore të garantojnë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes.

Legjislacioni aktual në Shqipëri përcakton detyrimin e bashkive për realizimin e njoftimit dhe konsultimit publik pothuajse për çdo vendimmarrje që ato kryejnë. Ndër ligjet kryesore që sanksionojnë detyrimin për angazhimin qytetar në vendimmarrjen lokale, më të rëndësishmit janë:

- Ligji Nr.146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik".
- Ligji Nr.119/2014 "Për të Drejtën e Informimit", i ndryshuar.
- Ligji Nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar.
- Ligji Nr.68/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
- Ligji Nr.107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit"

[7] Si burime primarë të informacionit u përdor ligji nr.146/2014, "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik", informacioni në lidhje me procesin e konsultimi public të publikuar në faqet zyrtare të bashkive respektive si edhe informacioni I përfituar nëpërmjet Kërkesave për Informim.

[8] Si burime sekondare: u përdorën raporte të tjera në lidhje me procesin e konsultimit të cilat shërbyen në përgatitjen e analizës krahasuese të progresit në çdo bashki në lidhje me procesin e konsultimit.

Duke iu referuar Ligjit Nr.139/2015 për Vetëqeverisjen Vendore, bashkia si organ ekzekutiv dhe Këshilli Bashkiak si organ përfaqësues kanë detyrimin të sigurojnë transparencën e veprimtarive[9] të tyre në procesin e vendimmarrjes.

Angazhimi i komunitetit në qeverisjen lokale, ndër të tjera, mundësohet përmes konsultimeve publike, duke sjellë në vëmendje përgjegjësitë e organeve vendore të njohin dhe zbatojnë në praktikë detyrimet që rrjedhin nga Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Ky ligj rregullon marrëdhëniet për realizimin e procesit të konsultimit publik, në vendimmarrjet që i përkasin hartimit të projektakteve, të tilla si projektligje, dokumente strategjike kombëtare dhe lokale, si dhe politika me interes të lartë publik.

## 6. Përshkrimi i strukturës së qeverisjes lokale në bashkinë Vau Dejës:

**Informacion i përgjithshëm**: Bashkia e Vau-Dejës bën pjesë në Qarkun e Shkodrës, me distancë 20 km nga Shkodra, 92 km nga Tirana. Ajo ka një sipërfaqe prej 468 km² ku 10 465 ha janë tokë bujqesore. Bashkia e Vau-Dejës kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë e Shkodrës, në lindje me Bashkinë Fushë-Arrëz ndërsa në jug me Bashkitë Pukë dhe Lezhë. Që prej Reformës Administrativo-Territoriale të vitit 2015, Bashkia Vau Dejës përbëhet nga 6 njësi administrative me një popullsi prej 50 130 banorë, përkatësisht: Vau-Dejës me 13 035 banorë, Bushat me 24 200 banorë, Vig-Mnelë me 2 177 banorë, Hajmel me 6 300 banorë, Temal me 2 520 banorë dhe Shllak me 1 899 banorë.

Bashkia ka nën administrimin e saj qytetin e Vaut të Dejës, 47 fshatra dhe zgjerohet në 5 njësi administrative. Aktivititeti kryesor ekonomik është bazuar në bujqësi dhe blegtori, biznesi i vogël dhe shërbimet si dhe turizëm. Vau-Dejës gjithashtu ka një zhvillim në sektorin e prodhimit të energjisë, me hidrocentralin e Vaut të Dejës, të Komanit, me HEC-et Ashta 1 dhe Ashta 2. Në Bashkinë e Vau i Dejës ndodhet dhe Landfilli rajonal i Bushatit, si pikë grumbullimi dhe përpunimi i mbetjeve për rajonin Shkodër – Lezhë. Njësitë administrative financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga buxheti i shtetit dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet, si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

<u>Kryetari i Bashkisë</u>

*Kryetari i Bashkisë* është figura ekzekutive kryesore e qeverisjes lokale në Bashkinë Vau Dejës. Në zbatim të Ligjit të Vetqeverisjes Vendore ka përgjegjësi që:

- Nëpërmjet urdhërave dhe vendimeve, organizon dhe drejton punën e administratës për kryerjen e funksioneve të Bashkisë.
- Zbaton aktet e Këshillit Bashkiak

<u>Nën/Kryetarët e Bashkisë:</u> Bashkia Vau Dejës ka dy nënkryetarë, një grua dhe një burrë.

Administrata bashkiake është struktura ekzekutive e bashkisë, e cila funksionon nën drejtimin e Kryetarit të Bashkisë, përfshin departamente dhe njësi të ndryshme dhe numri i pozicioneve

---
[9] Neni 16 dhe neni 18 i ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

është si në vijim: 9 pozicione funksionarë politikë; 62 pozicione nëpunës civilë; 49 pozicione punonjës administrative dhe specialistë të fushave të ndryshme.[10]

Këshilli Bashkiak Vau Dejës, si organ legjislativ i qeverisjes lokale për mandatin katërvjeçar 2023 – 2027 përbëhet nga 31 anëtarë që vijnë nga disa forca të ndryshme politike. Kryetari dhe Sekretari jane të gjinisë mashkullore, ndërsa nënkryetarja është e gjinisë femërore. Të ndarë sipas gjinisë janë 19 M/12 F. Anëtarët e KB kanë ngritur 13 komisione të përbërë nga 3 anëtarë secili. 6 nga këto komisione drejtohen nga gra dhe vajza, 6 nga këto komisione kanë zv.kryetare vajza dhe gra dhe në 4 komisione grate dhe vajzat janë sekretare komisioni.

**Dokumentet që influencojnë mekanizmat e pjesëmarrjes qytetare dhe transparencës**

Me qëllim krijimin e një marrëdhenie të mirë dhe korrekte është shumë e rëndësishme garantimi i komunikimit të vazhdueshëm ndërmjet punonjësve të institucioneve publike dhe qytetarëve. Bashkia Vau Dejës dhe Këshilli Bashkiak Vau Dejës përdorin mjete dhe forma të ndryshme për të komunikuar me qytetarët, duke përfshirë vendimet, njoftimet publike, konsultimet publike dhe pyetësorë online e megjithatë mund të pohojmë se nuk përdorin të gjitha mjetet që ligji i ka dhënë atyre.

Rregulloret dhe dokumentet e tjera shërbejnë për të strukturuar dhe rregulluar këto procese, duke krijuar një mjedis më transparent dhe duke siguruar rritjen e pjesëmarrjes të qytetarëve në proceset vendimmarrëse.

Këshilli Bashkiak Vau Dejës ka pesë rregullore kryesore[11]. Këshilli Bashkiak, si organi përfaqësues dhe vendimmarrës i qeverisë bashkiake, i ushtron përgjegjësitë e tij qeverisëse, duke respektuar parimet e demokracisë vendore, transparencës qeverisëse, ligjshmërisë, si dhe duke përdorur me ekonomi, efiçencë dhe efektivitet burimet njerëzore, financiare, fizike e natyrore, si dhe teknologjike të Bashkisë. Këshilli Bashkiak, si ogani përfaqësues i qeverisë bashkiake ka tre role kryesore: 1- përfaqësues, 2- vendimarrës dhe 3- mbikqyrës. Qeverisja bashkiake përfaqësuese dhe demokratike kërkon që Këshilltarët Bashkiakë të jenë të pavarur, të paanshëm dhe të përgjegjshëm ndaj banorëve, zgjedhësve territorit të juriksionit të vendimmarrjes së tyre; që vendimet dhe politikat e Këshillit Bashkiak të bëhen në interes të komunitetit dhe territorit të Bashkisë,

**Rregulloria për organizimin dhe funksionimin e Këshillit Bashkiak Vau Dejës[12]**

Nga shqyrtimi i kësaj rregulloreje vëmë re se KB ka disa të drejta dhe detyrime për të organizuar njoftimin dhe konsultimin publik dhe për të drejtën e informimit:

- Neni 133 - Informimi dhe Konsultimi publik i projekt buxhetit: Është parashikuar mënyra e dokumentimit dhe reflektimi i propozimeve për ndryshime në Projekt-Buxhet, pas konsultimeve publike dhe publikimi i tyre.
- Neni 134 - Dokumentimi dhe reflektimi i propozimeve për ndryshime në Projekt-Buxhet, pas konsultimeve publike dhe publikimi i tyre.

Gjithashtu përcaktohen dhe detyrat e përgjegjësitë e Sekretarit të Këshillit në lidhje me marrëdhëniet me komunitetin, në respektim të:

---

[10] https://www.vaudejes.gov.al/organograma
[11] Regullore të Këshillit Bashkiak Vau Dejës: https://www.vaudejes.gov.al/rregullore-per-keshillat-bashkiake/

- Ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", në lidhje me kërkesat e qytetarëve/OJF/person fizik dhe juridik për dokumente dhe informacionet për vendimet e Këshillit.
- Iniciativat dhe nismat qytetare (duke përfshirë peticionet) për vendimmarrjen e Këshillit, të përcaktuara në nenin 20 të Ligjit 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.
- Konsultimet publike në respektim të Ligjit 146/2014 "Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik".

**Rregulloria e Këshillit që rregullon marrëdhëniet me publikun dhe konsultim me mediat**
Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat e informimit të publikut dhe transparencën e politikëbërjes, vendimmarrjes dhe veprimtarisë së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, këshillimin e Këshillit me publikun dhe palët e interesuara përgjatë proçesit të politikëbërjes dhe vendimmarrjes, si dhe marredhëniet me median, gjatë ushtrimit të funksioneve dhe realizimin e detyrave të dhëna me ligj dhe ato për të cilat Këshilli ka diskrecion ligjor. Kjo rregullore merr një rëndësi të veçantë pas fillimit të procesit të publikimit të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak në media sociale pasi garanton pjesmarrjen aktive të publikut, rrit transparencë duke përmirësuar standarte si dhe garanton një vendimmarrje të ligjshme, efikase dhe efiçente të Këshillit.

**Rregullore për ngritjen dhe funksionimin dhe ndërveprimin e strukturave komunitare në Bashkinë Vau Dejës**: Strukturat komunitare janë organizime vullnetare të komunitetit që ngrihen, zgjidhen dhe funksionojnë sipas ligjit dhe kësaj rregulloreje.

Në bazë të nenit 84 kryesia apo këshilli nxit dhe mobilizon banorët të marrin pjesë në takimet dhe konsultimet publike të organizuara nga Bashkia, në lidhje buxhetin vjetor të Bashkisë, paketën fiskale, përcaktimin e prioritet strategjike, planifikimin e zhvillimit të territorit, hartimin e planeve të shërbimeve publike, zbatimin e projekteve zhvilluese, shitjen apo dhënjen me qera të pronave bashkiake, zbatimin e projekteve dhe bërjen e investimeve me ndikim në mjedis, etj.
Kryesia apo Këshilli nxit dhe mobilizon banorët të marrin pjesë në takimet dhe konsultimet publike të organizuara nga Bashkia, në lidhje buxhetin vjetor të Bashkisë, paketën fiskale, përcaktimin e prioritet strategjike, planifikimin e zhvillimit të territorit, hartimin e planeve të shërbimeve publike, zbatimin e projekteve zhvilluese, shitjen apo dhënjen me qera të pronave bashkiake, zbatimin e projekteve dhe bërjen e investimeve me ndikim në mjedis, etj.

Të gjitha këto rregullore janë të ngarkuara në faqen e internetit të Bashkisë Vau Dejës, Këshillit Bashkiak.[13]

**Rregjistri elektronik i projektakteve për konsultim publik, të Këshillit Bashkiak.**
Për këtë periudhë raportimi janë pasqyruar në regjistrin elektronik[14] 6 dëgjesa publike. Krahas linkut të publikuar gjejmë të publikuar, raportin, procesverbalin si dhe listeprezencën e personave që morën pjesë në dëgjesën publike. Kjo tregon se bashkia në bashkëpunim me KB kanë zhvilluar me seriozitet procedurat për prezantimin e projektakteve për konsultim.

---

[13] https://www.vaudejes.gov.al
[14] https://www.vaudejes.gov.al/rregjistri-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit-bashkiak/

**Plani i konsultimeve të Këshillit Bashkiak Vau Dejës:**
Plani i aktiviteteve i Këshillit Bashkiak të Vau Dejës dhe ai i konsultimeve publike është i publikuar vetëm për vitin 2024 i cili është miratuar me VKB Nr. 94, datë 21.12.2023, "Për miratimin e planit të aktiviteteve 2024 dhe planit të konsultimeve publike 2024". Ky plan përmban kalendarin e aktiviteteve me bazë mujore, por nuk është i botuar tek Programi i Transparencës. Megjithatë, vlen për tu cituar që për herë të parë e gjejmë këtë plan të publikuar në website të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

**Projektvendimet e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak**
Projektvendimet e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak të Vau Dejës janë të publikuara në faqen e internetit të Bashkisë. Përveç projektvendimeve, në këtë faqe janë publikuar edhe njoftimet për mbledhjet dhe relacionet për çështjet e trajtuara.

Bashkia Vau Dejës ne bazë të Urdhrit Ekzekutiv nr.17, dt.16.02.2017 të Kryetarit të Bashkisë të asaj kohe, rezulton se ka të miratuar një rregullore për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës si dhe të Njësive Adminsitrative. Bazuar në këtë rregullore neni nr. 32 përshkruan procedurën për seancat e këshillimit për bashkësinë, drejtimi i saj bëhet nga urdhrat që nxjerr kryetari i bashkisë dhe rregjistrimi i tyre bëhet në një protokoll të veçantë.

Në përputhje me dispozitat e ligjit në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik, Bashkia është e detyruar të garantojë pjesëmarrjen publike në procesin e vendimmarrjes. Për këtë qëllim, caktohet një koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik.

Bashkia Vau Dejës me shkresë zyrtare me nr.3310/1 prot, dt 23.05.2024 ka informuar se nuk ka një Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik. Mungesa e këtij përsoni në organikën e Bashkisë tregon edhe për një nivel të ulët të përfshirjes së qytetarve ne proceset e konsultimit publik dhe në vendimmarrje. Në këto kushte sugjerohet që Bashkia të ndërmarrë hapa konkret duke parashikuar një funksion të tillë në organikën e saj i cili sugjerohet të mos ketë detyra të tjera. Detyrat e tij të parashikohen qartazi në rregulloren e Bashkisë e cila duhet të publikohet edhe në website me qëllim rritjen e transparencës. Gjithashtu, sugjerohet edhe një rishikim i kësaj rregullore duke vlerësuar se ajo është miratuar në vitin 2017[15] dhe që atëherë shumë ligje dhe akte nën ligjore kanë ndryshuar.

**Programi i Trasparencës**
Është një tjetër dokument i rëndësishëm, që pas miratimit të tij nga autoritetet publike, në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme, vihet në dispozicion të publikut në faqen e tyre në internet. Ky program, ka si qëllim plotësimin e detyrimit ligjor për informimin e publikut si edhe transparencën e administratës së bashkisë dhe këshillit bashkiak, për proçedurën dhe miratimin e akteve të ndryshme.

Në faqen zyrtare të internetit të Bashkisë Vau Dejës gjendet Programi i Transparencës[16]. Kjo platformë është relativisht e lehtë për t'u përdorur dhe e mirëstrukturuar, duke përfshirë disa fusha, ndër të cilat edhe Fusha VI: Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje. Programi i cili është rishikuar me vendim të KB nr.24 parashikon që për zbatimin e tij ngarkohet Drejtoria e Informimit Publik, Medias, Statistikës dhe TIK, që në të njëjtën kohë është dhe drejtoria që

[15] https://www.vaudejes.gov.al/rregullorja-e-bashkise-vau-dejes/
[16] Programi i Transparencës, bashkia Vau Dejës https://www.vaudejes.gov.al/programi-i-transparences-2/

mbulon dhe procesin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik. Pritet që në vazhdim të sigurohen informacione të detajuara për qytetarët në lidhje me këtë program.
Në këtë program janë paraqitur qartazi publikimet në disa prej fushave të tij, por mbetet ende punë për tu bërë që të plotësohen të gjitha fushat me informacion të rifreskuar të viteve të fundit.
Ka informaicone të ndryshme të publikuara në lidhje me Konsultimet Publike, si dhe në lidhje me financat por këto nuk janë të azhornuara. Ka informacion të shkurtër dhe jo të plotë mbi detyrimet për njoftimin dhe konsultimin publik, aktet e detyrueshme për kryerjen e konsultimit publik, procedurën e marrjes dhe shqyrtimit të komenteve dhe rekomandimeve, procedurat që duhen ndjekur për të bërë një ankim, dhe procedurat për iniciativat qytetare.

## 7. Historiku i Procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik në bashkinë Vau Dejës

Procesi i njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Vau Dejës është relativisht i zhvilluar në vitet e fundit. Konstatojmë se vitet e fundit ka përpjekje të vazhdueshme për të rritur transparencën dhe pjesëmarrjen qytetare në vendimmarrje.

**Faza e hershme**
Mund të themi se Bashkia Vau Dejës, si njësi administrative, është krijuar në vitin 2000. Deri atëherë, nuk mund të flitej për një proces të njoftimit dhe konsultimit publik. Vendimmarrjet kryesisht ishin të centralizuara dhe roli i qytetarëve në këto procese ishte minimal, pothuajse inekzistent. Komunikimi me publikun ishte sporadik dhe nuk kishte një strukturë të mirëpërcaktuar. Mes shumë përpjekjeve, Bashkia arriti të fillonte procesin e njoftimit dhe konsultimit publik, i cili fillimisht ishte shumë larg standardit që është arritur aktualisht.

**Përdorimi i teknologjisë**
Me përhapjen e internetit dhe teknologjive të reja, Bashkia Vau Dejës filloi të përmirësojë metodat e njoftimit dhe konsultimit publik.

- **Mediat Sociale:** U nis përdorimi i mediave sociale si një mjet i ri për njoftime dhe për të ndërtuar një kanal komunikimi me qytetarët.
- **Webfaqja zyrtare**: Bashkia krijoi një faqe zyrtare në internet, ku publikohen informacione mbi vendimet, projektet dhe aktivitetet e Bashkisë.

Megjithatë, duhet theksuar se, duke qenë një bashki rurale, njoftimet nga kryepleqtë e fshatrave vazhdojnë të jenë një mjet efektiv, ashtu si edhe publikimi i njoftimeve pranë njësive administrative. Kjo nuk do të thotë që Bashkia të mos përdorë të gjithë kanalet e komunikimit dhe njoftimit për qytetarët e saj.

**Formalizimi i procesit**
Me miratimin e Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik në vitin 2014, Bashkia Vau Dejës përmirësoi dhe formalizoi proceset e saj të njoftimit dhe konsultimit publik. Ky ligj krijoi një kornizë ligjore për pjesëmarrjen e qytetarëve dhe organizatave të shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse. Përmes këtij ligji, Bashkia u detyrua të sigurojë njoftime për publikun mbi

vendimet dhe politikat e propozuara dhe të organizojë konsultime publike për të mbledhur opinione dhe sugjerime.

Megjithatë, nga një hulumtim i kryer në faqen zyrtare të Bashkisë, mund të themi se ky proces është relativisht i vonë, i shtrirë kryesisht në 7-10 vitet e fundit.

**Periudha e konsolidimit**

Pas miratimit të ligjit, Bashkia Vau Dejës ndërmori hapa për të konsoliduar procesin e konsultimit publik. U krijuan mekanizma specifikë për të garantuar pjesëmarrjen e qytetarëve dhe palëve të interesuara. Këto përfshinin:

- **Portalet elektronike**: U krijuan portale online ku qytetarët mund të informohen mbi vendimet e ardhshme dhe të japin sugjerimet e tyre. Në vitin 2018 Bashkia Vau Dejës krijoi faqen web "Programi i Tansparencës".
- **Pytësorë online** për konsultime publike, ku qytetarët mund të japin mendimet e tyre për buxhetin afatmesëm, e përdorur së fundmi gjatë vitit 2023.[17]
- **Takime publike dhe dëgjesa**: Bashkia organizon takime publike dhe dëgjesa me qytetarët për të diskutuar mbi çështje të ndryshme që prekin komunitetin.
- **Transmetime live**: Mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe aktivitete të tjera transmetohen live në faqen Facebook të KB Vau Dejës, duke kontribuar për një transparencë më të madhe dhe një mundësi më të gjerë për qytetarët që të jenë të informuar dhe të përfshirë dhe këto mbledhje pasqyrohen edhe në rregjistrin e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak dhe mund të ndiqen në cdo moment.

**Përpjekjet për përmirësim**

Në vitet e fundit, Bashkia Vau Dejës ka intensifikuar përpjekjet për të përmirësuar më tej proceset e njoftimit dhe konsultimit publik. Këto përfshijnë:

- Fushatat informative: Janë ndërmarrë dhe duhet të ndërmerren fushata informative për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve mbi të drejtat e tyre për të marrë pjesë në proceset vendimmarrëse. Këto fushata duhet të shtrihen në të gjithë njësitë administrative si dhe të kenë target edhe të rinjtë.
- Bashkëpunimi me OSHC-të: Bashkia ka forcuar bashkëpunimin me organizatat për të siguruar një pjesëmarrje më të gjerë dhe të larmishme në konsultime.

Historia e proceseve të njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Vau Dejës edhe pse një bashki relativisht e re, vitet e fundit reflektohet një përpjekje e vazhdueshme për rritje të transparencies. Pavarsisht këtij progresi, ka ende shumë hapësirë për përmirësim. Për të arritur një përfshirje më të gjerë dhe efektive të qytetarëve, është e nevojshme të përdoren të gjitha mjetet e vëna në dispozicion nga ligji madje të zhvillohen dhe metoda të reja. Po kaq e rëndësishme është edhe marrja në konsideratë e sugjerimeve/mendimeve të dhëna nga banorët gjatë procesit të konsultimit sepse kjo jo vetëm rrit transparencën por njëkohësisht rrit edhe besueshmërinë ndaj tyre.

**Realizimi i procesit të njoftimit dhe konsultimit publik për dy vitet e fundit**

---

[17] https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSfny_ygEPuAbXDj5lqpBTMgWxhjUhkV1T5RJm-4uei2zQaOWw/

Konsultimi publik për programin buxhetor afatmesëm 2024 – 2026

- Sondazh online: Këshilli Bashkiak i Vau Dejës ka kryer procedurat për njoftimin dhe konsultimin publik për qytetarët dhe grupet e interesit në përputhje me Ligjin Nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

Gjatë muajit Shkurt 2023, Këshilli Bashkiak Vau Dejës ka realizuar një sondazh online për përcaktimin e prioriteteve të komunitetit. Ky sondazh u ka dhënë mundësinë komunitetit të rekomandojë funksionet/shërbimet prioritare për të cilat Bashkia duhet të shpenzojë më shumë para gjatë vitit të ardhshëm 2024, në kuadër të përgatitjes së tavaneve buxhetore 2024-2026. Pyetësori dhe rezultatet e dala nga pyetësori janë të publikuara në faqën zyrtare të Bashkisë Vau Dejës.[18]

**<u>Konsultime publike</u>**

Gjatë periudhës Shkurt – Qershor 2024 janë kryer konsultime publike në lidhje me gjashtë projektakte: Plani-permiresimit-te-sherbimit-per-arsimin-parashkollor ndërsa 4 konsultimet e tjera publike janë realizuar në fshatra me qëllim marrjen e sugjerimeve nga banorë për dhënien me qera të sipërfaqeve të tokave dhe një konsultim public është realizuar në lidhje me ndryshimin e buxhetit dhe Progamin Buxhetor Afatmesëm.

Për të garantuar pjesëmarrjen aktive të qytetarëve dhe transparencën në vendimmarrje, në bashkinë Vau Dejës ashtu sikurse edhe në shumë Bashki të tjera të Shqipërisë janë ngritur mekanizma të ndryshëm, të tillë si **Seancat e hapura të mbledhjeve të Këshillit Bashkiak**: Seancat e hapura për publikun, ku qytetarët mund të marrin pjesë dhe të shprehin opinionet e tyre. Këto mbledhje transmetohen live në faqen Facebook të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.[19] Gjithashtu, aty publikohen ftesat për konsultime publike me banorët dhe grupet e interesit.

## 8. Vlerësim i efektivitetit dhe transparencës së procesit të konsultimit publik

Për të vlerësuar efektivitetin e transparencës së procesit të konsultimit publik, rrjeti POP bazuar në metodologjinë e studimit hartoi dhe shpërndau: (i) Kërkesë për informacion drejtuar bashkisë; (ii) realizoi intervista të thelluara me staf të bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; (iii) monitoroi publikimet në faqen e internetit të bashkisë dhe raporte alternative të prodhuara nga palë të treta; (iv) asistoi nga afër konsultime publike nga njoftimi i projekt-aktit deri në miratimin përfundimtar të tij. Rrjeti POP dhe Hapa të Lehtë përgatitën një kërkesë për informacion, ku përgjigja është dhënë brenda afateve ligjore me email. [20]

[18] Pyetësori online dhe analzia e përgjigejve të dala nga pyetsori. https://docs.google.com/forms/d/e/

[19] Faqia Facebook e Këshillit Bashkiak Vau Dejës https://www.facebook.com/KBVauDejes

[20] Kthimi i përgjigjes nga bashkia Vau I Dejsës Me shkresën nr.3310/1 prot, date 23.05.2024 kanë kthyer përgjigje shkresave nr.75 dhe 76 prot. Me shkresën nr.3734 prot, date 12.06.2024 Bashkia Vau Dejës u ka kthyer përgjigje shkresave nr.78, 79, 82, 83, dhe 84. Gjithashtu me shkresën nr.3439/1prot, dt.11.06.2024 Bashkia Vau Dejës I ka kthyer përgjigje shkresës nr. 80 prot, dt.22, 05.2024.

Nga përgjigjet e dërguara nga Bashkia, rezulton se Bashkia Vau Dejës nuk ka një Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik. Bashkia ka vënë në dispozicion linkun e regjistrit elektronik ku janë publikuar projekt-aktet e njoftimit për konsultim: https://www.vaudejes.gov.al/projekt-vendimet/ Në këtë link, rezulton se janë publikuar të gjitha vendimet e marra nga Këshilli Bashkiak Vau Dejës. Nga kontrolli i bërë këtij linku, rezulton se janë publikuar të gjitha vendimet duke filluar nga data 24.12.2020.

Bashkia ka dërguar edhe linkun ku është publikuar plani i aktiviteteve të Këshillit Bashkiak dhe vendimi për miratimin e këtij plani aktivitetesh: https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Vkb-nr.94-Dhjetor-2023.pdf Rezulton se plani i aktiviteteve të Këshillit Bashkiak është miratuar më 23.12.2023 me 23 vota pro nga 23 persona të pranishëm. Ky plan aktivitetesh është relativisht i detajuar, duke parashikuar disa aktivitete.

Në lidhje me kërkesën për mënyrën e njoftimit gjatë procesit të konsultimit publik, rezulton se Bashkia Vau Dejës ndjek dy nga katër metodat e parashikuara në ligj. Konkretisht, Bashkia Vau Dejës përdor postën elektronike dhe njoftimin publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik, si dhe në faqen zyrtare të Bashkisë, në rubrikën "Njoftime." Sa i përket mënyrës së marrjes së komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të konsultimit publik, Bashkia Vau Dejës në përgjigjen e saj shpjegon se përdor postën elektronike, si dhe formën verbale ose me shkrim, të regjistruara në procesverbalin e takimeve. Në përgjigjen e saj, Bashkia Vau Dejës thekson se për periudhën Shtator 2023 – Maj 2024 nuk ka pasur zgjatje apo përsëritje të fazës së konsultimit.

Po ashtu, janë publikuar të gjitha projekt-aktet e miratuara nga Këshilli Bashkiak Vau Dejës. Gjithashtu, përmes një shkrese zyrtare, Bashkia ka dërguar linkun e publikimit.

Në lidhje me transparencën, Bashkia Vau Dejës shprehet se për vitin 2023 nuk është hartuar një Raport Vjetor, pasi Bashkia nuk ka pasur një program transparence. Në vitin 2024, është miratuar programi i transparencës dhe Bashkia ka hartuar raportin për katërmujorin e parë të vitit 2024. Megjithatë, duke monitoruar faqen e Bashkisë Vau Dejës, rezulton se kjo Bashki kishte miratuar një program transparence më herët, konkretisht më 24.12.2018, me vendimin nr.108 të Këshillit Bashkiak, por që nuk rezulton të jetë zbatuar. Gjithashtu, nga monitorimi i faqes zyrtare të Bashkisë Vau Dejës rezulton se me vendimin nr.24, datë 27.03.2024, Këshilli Bashkiak ka miratuar, me 17 vota pro, Programin e Transparencës.

| Kërkesa për informacion | Pergjigjet e bashkisë Vau Dejës dhe Këshilli Bashkiak | Komente / Mjetet e verifikimit | Vlerësimi |
|---|---|---|---|
| 1. Emri, kontaktet e Koordinatorit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik dhe kopje të vendimit të emërimit të tij. | Nuk ka një person përgjegjës për Koordinatorin për njoftimin dhe konsultimin publik | Nga përgjigjet e dërguara nga Bashkia rezulton se Bashkia Vau Dejës nuk ka Koordinator për njoftimin dhe konsultimin publik. | **I parealizuar** |
| 2. Linkun e regjistrit elektronik ku janë publikuar projektaktet, e njoftimit për konsultim dhe të dhënave të lidhura me konsultimin e projektakteve sipas detyrimit të përcaktuar në nenin 6, pika 1, gërma a) të ligjit Nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”; | Këshilli bashkiak ka një regjistër elektronik ku janë plotësuar kërkesat dhe ankesat nga publiku: https://www.vaudejes.gov.al/rregjistri-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit-bashkiak/<br><br>Ndërsa bashkia ka vënë në dispozicion linkun e rregjistrit elektronik ku janë publikuar projekt aktet e njoftimit për konsultimin:<br><br>https://www.vaudejes.gov.al/projekt-vendimet/<br>Në këtë link rezulton se, janë publikuar të gjitha vendimet e marra nga Këshilli Bashkiak Vau Dejës. Nga kqyerja që ju bë këtij linku rezulton se janë të publikuar të gjitha vendimet duke filluar nga data 24.12.2020. | Bashkia më saktë Këshilli Bashkiak ka një regjistër elektonik ku janë publikuar njoftimet për konsultimin publik ku përfshihen të dhëna si: data; numri i protokollit; titulli i projektaktit; vendi i takimit; data, ora dhe pjesëmarrja e synuar si dhe afati kohor për të paraqitur rekomandime dhe komente. Gjithashtu ka relacion dhe dokumentat shoqëruese. Pra i gjithë procesi i unifikuar për të gjitha konsultimet publike. | **I realizuar** |
| 3. Kopje të planeve vjetore të organeve publike që lidhen me procesin e vendimmarrjes, te publikuara në programin e transparencës, sipas ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” | Bashkia ka dërguar link ku është publikuar plani I aktiviteteve të Këshillit Bashkiak si vendimin për miratimin e këtij plani aktivitetesh.<br><br>https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Vkb-nr.94-Dhjetor-2023.pdf<br>Rezulton se plani I aktiviteteve të Këshillit Bashkiak është miratuar me dt.23.12.2023 me 23 vota pro nga 23 persona që ishin të pranishëm. Ky plan aktivitetesh është relativisht I detajuar duke parashikuar disa aktivitete. | Vetë bashkia Vau Dejës nuk ka një raport të planit vjetor në lidhje me procesin e vendimmarrjes.<br>Në faqen e internetit te programi i transparencës gjendet një informacion i vitit 2021. Ende nuk janë hedhur të dhënat e rifreskuara për vitin 2023 dhe 2024.<br>Më shumë në:<br>https://www.vaudejes.gov.al/plani-vjetor-per-procesin-e-vendimmarrjes-pjesemarrje/<br><br>Këshilli bashkiak ndërkohë në planin vjetor të punës për 2024 | **I realizuar pjesërisht** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | | ka parashikuar edhe seanca të këshillimit me bashkësinë. | |
| **4. Mënyrat e njoftimit gjatë procesit të konsultimit publik që kryen bashkia Tiranë**<br>a) me postë elektronike;<br>b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik iniciues;<br>c) me një lajmërim në mediat audiovizive kombëtare, rajonale ose lokale;<br>d) me botimin në gazeta lokale ose në dy gazetat më të lexuara në nivel kombëtar. | Njoftimi për projektaktet që i nënshtrohen procedurës së konsultimit publik bëhet nëpërmjet:<br><br>a) me postë elektronike;<br>b) me lajmërim publik, i cili afishohet në ambientet e organit publik iniciues;<br><br>Marrja e komenteve dhe rekomandimeve në procesin e konsultimit publik kryhet në një nga format e përmendura më sipër, si dhe në raste të caktuara në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike. | Në lidhje me kërkesën për mënyrën e Njoftimit gjatë procesit të konsultiimit publik, rezulton se Bashkia Vau Dejës ndjek dy nga katër metodat e parashikuara ne ligj, konkretisht Bashkia Vau Dejës për të bërë njoftimet përdor posten elektronike dhe lajmërimit publik i cili afishohet në ambientet e organit public si dhe në faqen zyrtare të Bashkisë, rubrika njoftime si dhe në mediat sociale. | **I realizuar** |
| 5. Mënyrat e marrjes së komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të konsultimit publik<br>• me postë elektronike;<br>• në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike. | Sipas bashkisë Vau Dejës, mënyrat e marrjes së komenteve janë kryesisht:<br>- me postë elektronike;<br>- në formë verbale dhe/ose me shkrim e të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike. | Nga verfikimi dhe dokumentimi i dëgjesave që ka realizuar bashkia në periudhën e monitorimit, komente janë marrë me email, sondazhe online të zhvilluara nga KB për PBA-në si dhe nga pjesëmarrësit në takime rekomadnimet janë marrë në formë verbale, duke u rregjistruar në procesverbal. | **I realizuar** |
| 6. A ka patur raste kur është zgjatur ose | Nu ka patur raste të zgjatjes apo përsëritjes për periudhën e monitorimit (2023-2024) | Nga monitorimi i dokumetacionit të publikuar në faqen e internetit janë respektuar afatet për të | **I realizuar** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| përsëritur faza e konsultimit? | | paraqitur komentet dhe rekomandimet. Sipas bashkisë nuk ka patur raste të tilla. | |
| 7. Nese Po ju lutem na dërgoni arsyet si dhe kopje të aktit për të cilin është zgjatur ose përsëritur faza e konsultimit | Bashkia Vau Dejës në përgjigjen e saj në lidhje me konsultimin public shprehet se për periudhën Shtator 2023-Maj 2024 nuk ka pasur zgjatje apo përsëritje të fazes së konsultimit | Të gjitha njoftimet për konsultimet publike janë publikuar ne WEB-in e Bashkisë në rubrikën njoftime apo në faqen e facebook të Këshilli Bashkiak Vau Dejës | |
| 8. Kopje të njoftimit për takime publike | Faqja web e bashkisë dhe KB Vau Dejës shpërndahen njoftime për dëgjesa publike të cilave u lidhen dhe vendimet që KB ndërmerr<br>Më poshtë janë disa nga modelet si shpërndahen njoftimet për dëgjesat publike në faqen web të bashkisë.<br>https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2024/05/Plani-permiresimit-te-sherbimit-per-arsimin-parashkollor.pdf<br>https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2024/04/Degjese-07.05.2024Gomsiqe-1.pdf<br>https://www.vaudejes.gov.al/projekt-vendimet/ | Duke shqyrtuar dokumentacionin vendosur në dispozicion të kërkesës për informim, vihet re se njoftimet janë të unifikuara dhe të publikuara në faqen zyrtare të internetit të KB dhe bashkisw | **I realizuar** |
| 9. Kopje të Procesverbaleve të takimeve publike të zhvilluara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024 | Përgatiten për strukturën por në faqen e internetit nuk janë të publikuara (kopjet e procesverbale) për periudhën 2023 – 2024. | Në faqen e webit të bashkisë nuk janë publikuar procesverbalet e dëgjesave publike të realizuara nga bashkia | **Pjesërisht i Realizuar** |
| 10. Kopje të Projektakteve të miratuara gjatë periudhës Shtator 2023 – Maj 2024 shoqëruar me një përmbledhje të rekomandimeve të pranuara, dhe përmbledhje të arsyeve për rekomandimet e palëve të interesuara që nuk janë pranuar në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 146/2014 "Për | Në faqen e internetit, në seksionin njotime janë publikuar gjithë njoftimet për dëgjesat publike që përmbajnë vetëm njoftimin dhe projekt-aktin.<br>https://www.vaudejes.gov.al/njoftime/<br>Edhe KB shfaq në një rregjistër të posacëm gjithe konsultimet e zhvilluara duke bashkwlidhur projekt-aktet<br>https://www.vaudejes.gov.al/rregjistri-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit-bashkiak/ | Nga verifikimi në faqen e internetit ka raporte të projekt aktit por nuk ka të dhëna specifike për rekomandimet e pranuara apo përmbledhje të rekomandimeve apo komenteve të pranuara. | **Pjesërisht e realizuar** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| njoftimin dhe konsultimin publik” | | | |
| 11. Kopje të Raportit vjetor për transparencën në procesin e vendimmarrjes për vitin 2023 | Bashkia Vau Dejës nuk ka një raport vjetor mbi transparencën në procesin e vendimmarrjes për vitin 2023. | Pas verifikimit në faqen e internetit dhe kthim përgjigjen Nr.3734 Prot, dt 12/06/2024 është konstatuar se nuk është hartuar Raporti vjetor I transparencës. | **I pa realizuar.** |
| 12. Nëse ka patur ankesa në lidhje me procesin për njoftim dhe konsultim publik. Nëse PO ju lutem na dërgoni kopje të ankesave. | Në institucion nuk ka të depozituara ankesa në lidhje me procesin për njoftimin dhe konslutimin publik | Nga qytetarët apo grupet e interesit nuk ka ankesa për procesin e realizuar në periudhën Shtator 2023 – Maj 2024. | **I realizuar** |

## 8.1 Gjetje nga intervistat e realizuara me staf të bashkisë Vau Dejës dhe anëtarë të Këshillit bashkiak pranë kësaj bashkie

Procesi vazhdoi me intervista të drejtpërdrejta me stafin e Bashkisë Vau Dejës. Në mënyrë që të realizonim një vleresim sa më korrekt të praktikave që Bashkia Vau Dejës ndjek në lidhje me procedurat e njoftimit dhe konsultimit publik në këtë Bashki, kemi arritur të realizojmë 5 intervista nga 5 të planifikuara me staf nga Bashkia. Vlen për tu theksuar se Bashkia Vau Dejës nuk ka Koordinator për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, ky pozicion mbulohet nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe Transparencës. Ndërkohë duhet të pohojmë gadishmërinë e Nënkryetares së Bashkisë për të realizuar intervistën e planifikuar, por njëkohësisht na mundësoi intervistat edhe me pjesën tjetër të stafit. Të intervistuarit i përkisnin Drejtorisë Juridike dhe Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, Drejtorisë të Financave, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Pesë të intervistuarit nga Këshilli Bashkiak janë anëtarë të komisioneve të ndryshme, përfshirë edhe Kryetarin, dhe Sekretarin e Këshillit. Ata i përkasin këtyre komisioneve: Kryetare e Komisionit të Ekonomisë Vendore, Turizmit dhe Zhvillimit Rural, zv. kryetare e Komisionit të Etikës Standarteve dhe Apelimeve, dhe kryetaren e Komisionit për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Integrimin Europian.

Në përpjekjen tonë për të realizuar intervistën edhe me një anëtar të Komisionit të çështjeve Juridike u përballëm me faktin se Këshilli Bashkiak Vau Dejës nuk ka një komision të tillë në këto kushte u sugjerua që intervista të realizohej me Kryetaren e Komisionit të Marrëdhënieve me Jashte dhe Integrimin Europian.

Nga informacioni i marrë gjatë këtij procesi dhe analizës së tij, si dhe nga monitorimi, dolën në pah disa gjetje si më poshtë:

**Rëndësia e pjesëmarrjes së publikut dhe grupeve të interesit në procesin e hartimit dhe vendimmarrjes së Këshillit Bashkiak dhe njohja e bazës ligjore**

Pavarësisht roleve të ndryshme të të intervistuarve, të gjithë janë dakord që konsultimi dhe përfshirja e qytetarëve janë shumë të rëndësishme për një qeverisje efektive dhe të drejtë. Nga përgjigjet e të intervistuarve për pyetjen se sa e njohin bazën ligjore për angazhimin dhe konsultimin e publikut në vendimmarrjen vendore dhe nëse Këshilli Bashkiak i Vau Dejës ka një rregullore për konsultimin publik, 100% kanë konfirmuar njohjen e bazës ligjore dhe rregullores përkatëse. Në lidhje me vlerësimin që anëtarët e Këshillit Bashkiak kanë bërë për kuadrin ligjor mbi pjesëmarrjen dhe konsultimin publik në nivel vendor, analiza e përgjigjeve tregon se shumica (100%) e të anketuarve, vlerësojnë se kuadri ligjor mbi pjesëmarrjen dhe konsultimin publik është i qartë dhe i plotë.

***Gjetje**: Bashkia Vau Dejës duhet të përdor të gjitha metodat e paarshikuara në ligj por edhe metoda të tjera innovative për të garantuar një pjesëmarrje dhe konsultim publik më efektiv, gjithëpërfshirës dhe transparent.*

**Standartizimi Procedurës Administrative të Njoftimit dhe Konsultimit Publik**

Në lidhje me standardizimin e Procedurës Administrative të Njoftimit dhe Konsultimit Publik, anëtarët e stafit të bashkisë të intervistuar konfirmuan se procedura ishte e standardizuar, ndërsa njëri prej tyre nuk dha përgjigje.

Nga kërkimi ynë nuk rezultuan rregullore apo urdhëra të brendshëm në lidhje me këtë. Gjatë periudhës së monitorimit, në regjistrin elektronik të Këshillit Bashkiak[21] janë publikuar 5 projektakte. Njoftimet për konsultimet publike bëhen në kategorinë "Njoftime", në faqen e web-it të Bashkisë[22], kategoria Njoftime[23] dhe asnjëherë tek Programi i Transparencës.[24] Tek njoftimet janë vendosur: Njoftimi për dëgjesen publike, vendi ora e zhvillimit, kush ftohet të marrë pjesë, kush e paraqet, relacionim, raport, dhe projekt vendimi, kontakti me e-mail për dërgimin e komenteve, rekomandimeve dhe vërejtjeve, pa vendosur data.[25] Ka raste kur njoftimet janë të shkurtra dhe nuk i përmbajnë të gjitha elementet e përshkruara më lart.

***Gjetje**: Mospërdorimi i një forme të vetme për të gjitha njoftimet.*

**Mekanizmat dhe proceset e pjesëmarrjes dhe konsultimit me qytetarët**

Në lidhje me mekanizmat dhe proceset e pjesëmarrjes dhe konsultimit publik, të intervistuarit nga stafi i Bashkisë dëgjesat me grupet e ndryshme të interesit. Megjithatë, vlerësohet shumë e rëndësishme përfshirja në këtë proces e të gjitha drejtorive për të siguruar bashkëpunim dhe një zbatim të plotë dhe të përshtatshëm të procedurave, në përputhje me ligjin. Të intervistuarit nga Këshilli Bashkiak pohojnë se bashkëpunojnë me Bashkinë. Pyetjes nëse ka

[21] Regjistri i projekt akteve për konsultim publik, të Këshillit Bashkiak Vau Dejës: https://www.vaudejes.gov.al/rregjistri-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit-bashkiak/
[22] Faqja zyrtare Bashkia Vau Dejës: https://www.vaudejes.gov.al/
[23] https://www.vaudejes.gov.al/njoftime/
[24] Programi i Transparencës: https://www.vaudejes.gov.al/programi-i-transparences-2/
[25] https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/degjese-19.07.2024.pdf

bashkëpunim mes Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë për procesin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik.

Për pyetjen se si realizohet ky bashkëpunim, ata përgjigjen se kryesisht bëhet përmes sekretarisë dhe organeve përkatëse, me afishime në faqet e internetit të secilit institucion dhe njoftime nga administrata. Për të rritur pjesëmarrjen, veprimet kryhen në bashkëpunim me ekzekutivin. Njoftimet për takimet informuese me qytetarët realizohen në forma të ndryshme.

Ajo cfarë konstatojmë nga monitorimi i faqes zyrtare të Këshillit Bashkiak, rregjistrit elektronik për konsultimet publike që në Tetor të vitit 2022 publikohen Njoftimet, procesverbalet e mbajtur gjatë konsultimit publik gjithashtu edhe prezencen e personave prezent në këtë dëgjesë publike. Vëmë re që ka ardhur duke u rritur numri i përsonave që marrin pjesë në dëgjesat publike.[26]

**Për vitin 2024 janë realizuar konsultime publike si më poshtë:**

- Këshilli Bashkiak, në bashkëpunim me administratën e Bashkisë, realizoi konsultimin publik "Planin e përmirësimit të shërbimit të arsimit parashkollor 2024-2026".[27] Pjesë e konsultimit ishin edhe komuniteti, përfaqësues të zyrës arsimore vendore anëtarë të këshillave të prindërve dhe bordeve të kopshteve, për të marrë mendimin e tyre.
- Janë realizuar disa dëgjesa publike me banorët e Njësive Administrative Karmë, Gomsiqe, Stajkë, në lidhje me dhënien e siperfaqeve të tokave me qera.
- Gjithashtu është realizuar dëgjesë publike për ndryshimin e buxhetit.
- Referuar njoftimeve, është planifikuar të realizohet përseri me date 08.08.2024 dëgejsë publike në fshatin Gomsiqe për dhënie toke me qera.

***Gjetje**: Mosrespektimi i kalendarit të aktiviteteve të Këshillit Bashkiak për vitin 2024 për Konsultimin Publik mbi Hartimin e Planit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027*

**Procedurat për inicimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik dhe mjetet që përdoren për realizimin e tij**

Në lidhje me inicimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit publik, të intervistuarit nga stafi i Bashkisë pohuan se inicimi bëhet nga Kryetari i Bashkisë.

Pyetjes në lidhje me mjetet e njoftimit dhe konsultimit publik iu përgjigj koordinatorja për të drejtën e informimit. Ajo konfirmoi se informacioni për njoftimin publik afishohet në stendën e Bashkisë, nëpërmjet regjistrit elektronik dhe publikimeve në rrjetet sociale. Ajo gjithashtu nënvizoi rëndësinë e përfshirjes të të gjitha drejtorive për një koordinim më të mirë dhe për të siguruar që Procesi i Njoftimit dhe Konsultimit Publik të jetë transparent dhe gjithëpërfshirës dhe efektiv në të gjitha nivelet.

**Gjithashtu, nga këto intervista na rezulton që:**

- Ka një regjistër për Procesin e Konsultimit Publik, i cili përditësohet sistematikisht dhe përgjegjës për përditësimin e tij është koordinatorja për Informimin Publik. Ky regjistër është publikuar online dhe procesverbali i takimeve dhe konsultimeve me publikun gjithmonë publikohet.

---

[26] https://www.vaudejes.gov.al/rregjistri-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit-bashkiak/

[27] https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2024/07/Proces-verbal-degjesa-dhe-komisioni-SIP-_Vau-i-Dejes.pdf

- Komentet dhe rekomandimet në Procesin e Konsultimit Publik merren në formë verbale dhe regjistrohen në procesverbalet e takimeve publike.
- Përcaktohen vendi dhe mënyra për paraqitjen dhe dërgimin e rekomandimeve nga palët e interesuara, dhe adresat e kontaktit por nuk përcaktohet afati për dërgimin e tyre.

Megjithatë, në lidhje me pyetjen se kur publikohet vendi dhe data e organizimit të takimit publik në rastet kur organi publik vendos për organizimin e tij, nuk morëm përgjigje nga të intervistuarit nga stafi i Bashkisë. Ndërkohë, për sa i përket disponueshmërisë së infrastrukturës për realizimin dhe mbikëqyrjen e procedurave ligjore për njoftimin dhe Konsultimin Publik, përgjigjet e anëtarëve të Këshillit Bashkiak shfaqin një gamë të ndryshme qëndrimesh. Dy anëtarë pohojnë se infrastruktura është e disponueshme. Në anën tjetër, disa nuk japin përgjigje ose përgjigjen "jo".

Në lidhje me këtë rubrikë, nga monitorimi që kemi bërë, kemi arritur në gjetjet e mëposhtme:

✓ **Mungesa e publikimit të plotë të planeve vjetore në Programin e Transparencës**

Sipas ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", çdo organ publik ka detyrimin që në programet e transparencës të publikojë planet vjetore që lidhen me Procesin e Vendimmarrjes. Këto plane duhet të publikohen para fillimit të Procesit të Hartimit të Projektakteve dhe duhet të pasqyrojnë nismat përkatëse.

Duke iu referuar Programit të Transparencës së Bashkisë Vau Dejës, nuk ka të publikuar plan konsultimesh të këshillit bashkiak por u vu re se ishte publikuar vetëm plani i punës i Këshillit Bashkiak për periudhën Janar – Dhjetor 2024 tek rubrika Procesi i vendimarrjes i Këshillit Bashkiak/ Planet e Këshillit Bashkiak[28].

Mospublikimi i këtyre planeve tek Programi i Transparencës bie ndesh me detyrimet ligjore dhe kufizon mundësinë e qytetarëve për të marrë pjesë në mënyrë të informuar në proceset e konsultimit publik dhe vendimmarrjes.

✓ **Mungesa e koordinatorit për Konsultimin Publik**

Mungesa e një koordinatori të dedikuar për konsultimin publik tregon një mungesë të ndarjes së qartë të përgjegjësive brenda strukturave të Bashkisë. Kjo mund të çojë në ngatërresa dhe ngadalësim në proceset e konsultimit publik. Një person i dedikuar për Konsultimin Publik do të ishte më i fokusuar dhe më i aftë për të menaxhuar dhe koordinuar proceset e konsultimit, duke siguruar që të gjitha detyrimet ligjore dhe administrative të përmbushen plotësisht. Dy nga tre anëtarët e stafit të Bashkisë të intervistuar nuk kanë informacion se kush është koordinatori për Konsultimin Publik. Kjo tregon se nuk ka një komunikim të qartë dhe efektiv ndërmjet stafit.

✓ **Mungesa e përdorimit të gjitha mjeteve të njoftimit gjatë procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Vau Dejës**

[28] https://www.vaudejes.gov.al/procesi-vendimmarres-i-keshillit/

Në Bashkinë Vau i Dejës, mënyra e njoftimit gjatë procesit të Konsultimit Publik realizohet përmes një lajmërimi publik, i cili afishohet në stendën e Bashkisë Vau Dejës, njësive adminsitrative publikohet në faqen zyrtare të internetit, https://www.vaudejes.gov.al/njoftime/

në kategorinë "Njoftime" dhe faqet Facebook të Këshillit Bashkiak. Gjithashtu njoftimet bëhen edhe nepërmjet kryepleqve të fshatit. Kjo praktikë, nuk arrin të sigurojë një përfshirje sa më të gjerë dhe të drejtë të publikut në Procesin e Konsultimit Publik. Ligji nuk e ka të parashikuar në mënyrë taksative përdorimin e të gjitha formave, por përdorimi i më shumë formave të njoftimit do të ndikonte pozitivisht në proces.

- ✓ **Mungesa e mënyrave të marrjes së komenteve dhe rekomandimeve gjatë procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Vau Dejës**

Në Bashkinë Vau Dejës rezulton se komentet dhe rekomandimet gjatë procesit të konsultimit publik merren në formë verbale të regjistruara në procesverbalin e takimeve publike. Pavarësisht se, në Njoftimin e publikuar rezulton se rekomandimet mund të dërgohen edhe me shkrim, fakti që nuk citohet afati kohor për dërgimin e tyre, tregon që kjo metodë nuk realizohet. Mos përdorimi i kësaj metode mund të limitojë pjesëmarrjen e atyre qytetarëve të cilët për arsye të ndryshme nuk mund të marrin pjesë fizikisht dhe atyre personave që preferojnë komunikimin në mënyra të tjera.

Ndërkohë, në pyetjen nëse Këshilli Bashkiak ka infrastrukturën e duhur për realizimin dhe ndjekjen e procedurave ligjore për njoftimin dhe Konsultimin Publik, të gjithë këshilltarët (janë përgjigjur pozitivisht. Megjithatë duhet të vlerësojmë mungesën e transportit publik i cili mund të pengojë pjesmarrjen e qytetareve në dëgjesa publike, si dhe kohën e realizmit të tyre që përgjithsisht është ditë jave në orar zyrtar pune për Bashkinë ashtu sikurse edhe për banorët e tjerë të Bashkisë duke limituar në këtë mënyrë pjesmarrjen e tyre ne konsultime. Gjithashtu realizimi i disa dëgjesave në sallën e Këshillit Bashkiak limiton pjesmarrjen e përsonave me aftësi fizike të kufizuar.

- ✓ **Mungesa e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi të brendshëm të procesit të Njoftimit dhe Konsultimit Publik**

Në pyetjen nëse Këshilli Bashkiak ka një mekanizëm monitorimi dhe raportimi për Njoftimin dhe Konsultimin Publik, shumica e anëtarëve të intervistuar 60% e tyre janë përgjigjur pozitivisht raporti i fundit është realizuar me 31.05.2024. 20% e tyre shprehen se nuk kanë informacion dhe 20% e tyre shprehen se nuk ka sistem monitorimi. Në fakt rezulton se ky nuk është një monitorim i sistemit të procesit të Njoftimit dhe Konsultimti publik por një raport që rrit përformancën e transparencës së Bashkise në lidhje me buxhetin.[29] Nga ana tjetër, nga stafi i Bashkisë, shprehet se ka statistika në lidhje me përfshirjen e qytetarve në procesin e Njoftimit dhe Konsultimit Publik por nuk ka një sistem të brendshëm monitorimi dhe vlerësimi të porcesit. Të intervistuarit që kanë dhënë përgjigje pozitive kanë përmendur si shembuj monitorimin projektin "Bashki të Forta". Konstatojmë që me 13 Shkurt 2024 është hartuar dhe publikuar Raporti mbi punën e Këshillit Bashkiak për vitin 2023.[30]

---

[29] https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2024/06/6.Bashkia-Vau-Dejes-Dergim-Raporti-Monitorimit- 4mujori-i-pare-2024.pdf

[30] https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2024/02/11.Raport-i-punes-K.B-Vau-Dejes-2023..pdf

## Ankesa, kërkesa drejtuar Këshillit Bashkiak

Në faqen e Bashkisë Vau Dejës janë publikuar Rregullorja e Këshillit Bashkiak për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare[31], si dhe Regjistri i Ankesave dhe Kërkesave drejtuar Këshillit Bashkiak Vau Dejës.[32] Megjithatë, është vërejtur se regjistri përmban ankesa lidhur me problematika të ndryshme, por jo me konsultimin publik. Gjatë këtyre dy viteve të fundit nuk rezulton të ketë pasur ankesa apo kërkesa drejtuar Këshillit por kjo nuk e konfirmon faktin se procesi i Konsultimit publik ka qenë korrekt por mund të ketë mungesë informacioni nga qytetarët për ushtrimin e të drejtës së tyre të ankesës ose mund të mos kenë besim në funskionimin e sistemit të ankimimit.

## Mungesa e besimit të qytetarëve

Përfshirja e qytetarëve në proceset e konsultimit publik është shumë e ulët, kjo mund të vijë nga disa faktorë siç mund të jenë;

- Mungesa e besimit të qytetarëve, që përfshirja e tyre mund të ndikojë në vendimarrje.
- Mungesa e informacionit në lidhje me këtë të drejtë
- Indiferentizmi i anëtarëve të Këshillit Bashkiak për të nxitur pjesmarrjen e qytetarëve në këto procese.

## Programi i transparencës

Këshilli Bashkiak Vau Dejës me vendimin nr.24, dt.27.03.2024 ka miratuar me 17 vota pro Programin e Transparences për Bashkinë Vau Dejës. [33] Le të shpresojmë që miratimit i këtij programi do të ndikojë në rritjen e transparencës në Bashkinë Vau Dejës. Konstatojmë se kemi të publikuar Raportin e monitorimit të Bashkisë Vau Dejës për 4 mujorin e parë të vitit 2024.[34]

# 9. Përmbledhje e komenteve dhe rekomandimeve të grupeve të interesit e qytetarëve nga konsultimi publik

Me qëllim realizimin e këtij studimi, janë zhvilluar 30 intervista të thelluara me aktivistë dhe përfaqësues të komunitetit qytetarë nga grupet e interesit, ndërsa 124 qytetarë të Bashkisë Vau Dejës kanë plotësuar një pyetësor online. Pyetësorët përfshinin pyetje në lidhje me tema të ndryshme mbi Konsultimin Publik, siç janë: udhëzimet për fillimin e procedurave të Konsultimit Publik, përgatitjen dhe publikimin e kalendarit të Konsultimit Publik, njoftimin e Konsultimit Publik, realizimin e konsultimit, përgatitjen dhe publikimin e procesverbaleve, ndikimin e rekomandimeve të qytetarëve dhe grupeve të interesit në vendimet përfundimtare të aprovuara nga vendimmarrësit, si dhe publikimin e Raportit të Konsultimit Publik në regjistrin elektronik.

---

[31] Rregullorja e Këshillit Bashkiak për paraqitjen dhe shqyrtimin e ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare https://www.vaudejes.gov.al/rregullore-per-keshillat-bashkiake/

[32] Regjistri i ankesave dhe kërkesave drejtuar Këshillit Bashkiak Vau Dejës https://www.vaudejes.gov.al/rregjistri- ankese-kerkese-e-keshillit/

[33] Vendimi nr.24 I Këshillit Bashkiak për miratimin e Programit të transparencës https://www.vaudejes.gov.al/wp- content/uploads/2024/04/Vendimi-i-transparences.pdf

[34] Raportimi I monitorimit 4 mujori I pare https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2024/06/6.Bashkia- Vau-Dejes-Dergim-Raporti-Monitorimit-4mujori-i-pare-2024.pdf

Këto pyetësor ndihmuan në identifikimin e perceptimit të qytetarëve mbi efektivitetin e procesit të Konsultimit Publik. Ato na ndihmuan për të matur përfshirjen e qytetarëve dhe grupet e interesit, si dhe ndikimin e tyre në vendime.

## 9.1 Intervistat e thelluara me grupet e interesit

Me qëllim matjen e nivelit të njohurive dhe të angazhimit të qytetarëve, OSHC-ve dhe grupeve të interesit në Vau Dejës, Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë" realizoi 30 intervista të thelluara (17 F/13M) me aktivistë/përfaqësues të komunitetit dhe qytetarë (3 intervista me përfaqësues të OSHC-ve (3 F), 7 biznese (4F/3M), 20(10F/10M) aktivistë të shoqërisë civile dhe qytetarë.




Grafiku më poshtë tregon një rritje të ndërgjegjësimit të qytetarve mbi të drejtat e tyre dhe për rëndësinë e përfshirjes së tyre në proceset vendimmarrëse. Por institucionet lokale duhet të punojnë më shumë për të nxitjur gjithëpërfshirjen dhe pjesmarrjen e qytetarëve në konsultimet publike duke garantuar në këtë mënyrë gjithëpërfshirjen dhe rritjen e transparencës.




Nga intervistat e realizuara rezulton se pjesa me e madhe e qytetareve 83,3% marrin informacion nga rregjsitri elektronik, faqja zyrtare e internetit dhe 50% e tyre marrin informacion nga njoftimet e realizuara nga kryeplaku apo nga administratori. Ashtu siç rezultoi edhe më heret pjesa më e madhe e popullsisë jeton në zonë rurale prandaj edhe roli i kryeplakut është shumë i rëndësishëm. Nga verifikimi që i bëmë rregjistrit elektronik rezulton se aty hidhet informacion në lidhje me konsultimin publik por që nuk up-date në kohë reale.

https://www.vaudejes.gov.al/rregjistri-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit- bashkiak/




Kjo tregon se perceptimi qytetar nuk është shumë i saktë në lidhje me faqen e internetit dhe mediat sociale, kjo mund të krijojë një konfuzion midis këtyre dy të fundit.

Të intervistuarit në lidhje me pjesmarrjen e tyre në konsultimet publike u përgjigjen se 61% e tyre nuk kanë marrë pjesë në këto konsultime 27.5 % e tyre u shprehën se kanë marrë pjesë shumë rrallë dhe rrallëherë kanë dhënë rekomandime, ndërkohë 11.5% shprehen se kanë marrë pjesë rregullisht në dëgjesa publike dhe pjesmarrja e tyre ka qenë aktive duke dhënë sugjerime dhe rekomandime në lidhje me çështjen e ngritur për konsultim.




Sa i përket bashkëpunimit me Bashkinë ose Këshillin Bashkiak, pjesa më e madhe e të anketuarve pranojnë se nuk kanë pasur bashkëpunime me asnjërin nga këto institucione ashtu sikurse pjesa tjetër e të intervistuarve pohojnë se kanë pasur raste bashkëpunimi por që këto kanë qenë të pakta, ashtu sikurse një pjesë relativisht e vogël përgjigjen se kanë pasur mundësi bashkëpunimi shumë të mira me të dy këto institucione.

Pavarësisht se numri i personave që kanë dhënë rekomandime është realtivisht i ulët ato pohojnë se varsisht nga kjo këto rekomandime janë marrë pak ose aspak në konsideratë e lidhur kjo edhe me shumë arsye. Në lidhje me inicimin e konsultimit publik nga Bashkia apo Këshilli Bashkiak të intervistuarit nuk arrijnë të bëjnë shumë diferencën kjo pasi ato shprehen se në këto konsultime publike kanë marrë pjesë përfaqësues nga të dy institucionet.

Shumica e të intervistuarve pohojnë se nuk u është shpjeguar afati, vendi dhe mënyra me të cilën, do të paraqesin ose do të dërgojnë rekomandimet e tyre. Shumica e të anketuarve

pohojnë se nuk kanë dijeni për Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik (madje një pjesë e tyre e lidhin këtë figurë me atë të sekretarit të Këshillit Bashkiak).

Nga përgjigjet e të anketuarve konstatohet se pothuajse të gjithë të anketuarit nuk kanë informacion të saktë lidhur me kohën në dispozicion për të marrë pjesë në një konsultim publik dhe vetëm një numër krejt i ulët i të intervistuarve besojnë se rekomandimet e tyre janë marrë parasysh ndërsa pjesa tjetër e të intervistuarve shprehen se nuk e dinë por asgjë nuk ka ndryshuar në lidhje me kërkesat e tyre.

Shumë pak nga të intervistuarit besojnë se konsultimet publike kanë forcën e duhur për të sjellë ndryshime reale.

Në pyetjen nëse gjatë konsultimeve publike të organizuara janë vënë në dispozicion materiale të projektaktit për shqyrtim dhe dhënie rekomandimesh, të intervistuarit shprehen se nuk kanë pasur materiale në dispozicion por ato janë shpjeguar nga organizatorët. Ato shprehen se rekomadimet i kanë dhënë gjatë zhvillimit të konsultimeve dhe që mendojnë se janë mbajtur shënim nga organizatorët në procesverbal.

Asnjë i anketuar nuk referon të jetë ankuar në institucione të tjera që kanë për detyrë monitorimin.

Në lidhje me pyetjen "Cilat janë disa nga sfidat dhe vështirësitë që keni ndeshur në zbatimin e Ligjit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik me qytetarët dhe grupet e interesit që ju përfaqësoni?", përgjigjet e të anketuarve përfshijnë: mungesën e ndërgjegjësimit, shpesh mosaksesueshmërinë e informacionit, kohën dhe burimet e kufizuara, mungesën e besimit, pjesëmarrjen selektive, konsultimet joefektive, mungesën e kapaciteteve, mos përdorimin e rrjeteve sociale nga të gjithë, besimin, mos informimin e duhur dhe në kohë, mungesën e transparencës, realizimin e konsultimeve në kohë dhe vende jo të përshtatshme për të gjithë nevojën për përdorimin e formave të ndryshme të informimit për Konsultim Publik ku mesazhet në telefon apo e-mail janë më direkte dhe efikase për të zgjuar interes për informimin e mëtejshëm për konsultimin publik, mungesën e interesit nga qytetarët dhe mos njoftimin në kohë.

Pjesa më e madhe e të anketuarve pranojnë se vitet e fundit është rritur aktivizimi i qytetarëve pas zbatimit të Proceseve të Informimit dhe Konsultimit megjithatë kjo rritje është shumë e vogël në raport me rëndësinë që ka përfshirja e qytetarëve në këto procese. Ata që besojnë se është rritur aktivizimi i qytetarëve, mendojnë se ky aktivizim është rritur duke marrë parasysh apo duke dhënë sugjerime, duke rritur pjesëmarrjen qytetare, falë mbështetjes së disa organizatave që ndihmojnë qytetarët, si dhe për shkak se qytetarët sot janë më aktivë dhe më të ndërgjegjësuar për pjesëmarrje në aktivitete të Bashkisë që kanë ndikim në komunitet apo që lidhen direkt me interesin e tyre. Ky aktivizim është arritur edhe duke koordinuar përpjekjet me të gjitha palët e interesuara, përfshirë institucionet publike, qytetarët, organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, për të krijuar një proces gjithëpërfshirës, transparent dhe efektiv por edhe nëpërmjet rritjes së transaprencës sic është zhvillimi i mbledhjeve të Këshillit Bashkiak online apo ngritja dhe vënia në funksion e disa mekanizmave si koordinatori për të drejtën e informimit. Një pjesë e konsiderueshme mendon se ka ende një mungesë besimi tek grupet e interesit në Procesin e Konsultimit Publik dhe tek institucionet që e realizojnë atë.

Rezultatet e mësipërme tregojnë se grupet e interesit dhe qytetarët kanë perceptime dhe përvoja të ndryshme lidhur me procesin e Konsultimit Publik. Gjithsesi të dy grupet evidentojnë nevojën për përmirësime në informimin, transparencën dhe përfshirjen në proceset vendimmarrëse. Diferencat në perceptime dhe përvoja vijnë nga nivele të ndryshme informimi, burime informacioni, angazhim dhe besim në proces, si dhe sfida specifike që hasin secili grup. Kjo sugjeron nevojën për strategji të ndryshme për të rritur informimin, përfshirjen dhe besimin në proceset e konsultimit publik për të dy grupet.

Kjo analizë e pyetësorit tregon se, në përgjithësi, Procesi i Konsultimit Publik në Bashkinë Vau Dejës ka filluar të ketë përmirësim por ka ende shumë punë për të bërë për të nxitur pjesmmarjen aktive të qytetarëve dhe përfshirjen e tyre në këto procese.

Prandaj kjo analizë na ndihmon për të kuptuar mbi rëndësinë që ka rritja e transparencës dhe e besimit në insitucionet publike që mund të cojë në një rritje të pjesmarrjes aktive të qytetarëve duke kontribuar jo vetëm me pjesamrrje dhe që kjo e fundit të jetë gjithëpërfshirëse si përsa i përket moshës, territorit, por edhe kritereve të tjera por kjo pjesmarrje të jetë aktive dhe të japë rekomandime të vlefshme që duhet të konsiderohen nga institucionet publike ne momentin e vendimmarrjes.

## 9.2 Perceptimet e qytetarëve përmes vlerësimit online.

Pyetësori u plotësua nga 124 qytetarë të bashkisë Vau Dejës. Plotësimi i këtij pyetësori na ofron një pasqyrë deri diku reale mbi perceptimet dhe përvojat e tyre lidhur me Procesin e Konsultimit Publik.

Në total, 42 qytetarë nga zonat urbane (34%) dhe 82 qytetarë nga zonat rurale (66%), morën pjesë në plotësimin e pyetësorit. Kjo shpërndarje demografike tregon se pjesa më e madhe e të anketuarve vijnë nga zona rurale, duke reflektuar një përqendrim më të madh të popullsisë në njësi administrative. Nga të anketuarit, shumica janë femra (68%), ndërsa meshkujt përbëjnë 29% të të anketuarve. Kjo tregon një përfshirje më të madhe të femrave në procesin e plotësimit të pyetësorit ndofta edhe për vetë fakin se Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë", pjesë e rrjetit POP punon më së shumti në zonat rurale dhe me gra. Ajo që konstatojmë është mos deklarimi i gjinisë në masë 3% e atyre që kanë plotësuar pyetësorin.




Të anketuarit janë të ndarë në grupe moshore të ndryshme, Ashtu siç rezultoi edhe në grafikun e mësipërm edhe në këtë grafik gra të moshës 30-45 vjeç e kanë plotësuar më së shumti pyetësorin. Ndërkohë rezulton se 1% e personave të moshës 15-29 vjeç dhe 46-65 vjeç pothuajse kanë shfaqur të njëjtin interes për plotësimin e pyetësorit. Krejtësisht e kuptueshme që vetëm dy persona të moshës mbi 65 vjeç kanë plotësuar pyetësorin kjo për vetë faktin se ato janë me pak përdorues jo vetëm të rrjeteve sociale por edhe të teknologjisë dhe informacionit.




Vetëm 59.2% e të anketuarve pohojnë se kanë njohuri mbi Ligjin për Konsultimin Publik, ndërsa 40.8% shprehen se nuk e njohin. Kjo tregon një mungesë të informimit dhe ndërgjegjësimit mbi legjislacionin për Konsultimin Publik nga ana e qytetarëve. Mungesa e këtij informacioni dhe kësaj njohurie mund të bëhet pengesë në mënyrë të drejtë për drejtë edhe në përfshirjen e tyre në vendmiarrjen lokale që mund të ndikojë në mënyrë të drejtë për drejtë në jetën e tyre. Në këto kushte vlerësojmë se duhet të punohet shumë në drejtim të edukimit qytetar rreth ligjit për konsultimin public sidomos edukimi i hershëm i të rinjve në mënyrë që të rritet pjesmarrja e qytetarëve në këto procese dhe që kjo pjesmarrje të jetë aktive.



Të pyetur në lidhje me informimin për dëgjesat publike banorët e Bashkisë Vau Dejës që kanë plotësuar pyetësorin online shprehen se njoftimin e kanë marrë kryesisht nepërmjet njoftimit të publikuar në ambientet e Bashkisë/ Njësive administrative, njoftimit nga kryeplaku apo administratorit si dhe nepërmjet rrjeteve sociale. Ajo cfarë konstatohet nga plotësimi i pyetësorit është se qytetarët pohojnë që janë njoftuar nepërmjet mediave audiovizive, mjet ky që nuk pohohet të përdoret nga Bashkia Vau Dejës. Kjo tregon që banorët nuk kanë qenë shumë të qartë në pyetje ndofta duke u konfuzuar me rrjetet sociale, prandaj nuk ka edhe nje perqindje të lartë të klikimit në mediat sociale.




Qytetarët e pyetur në lidhje me pjesmarrjen e tyre në dëgjesat publike të organizuara nga Keshilli Bashkiak apo Bashkia më së shumti, 61% e tyre janë përgjigjur që nuk kanë marrë pjesë në dëgjesat publike të organizuara në dy vitet e fundit. Nga përgjigjet e marra konstatohet një mungesë e ulët interesi nga ana e grupeve të përfshira në dëgjesat publike madje adhe ato që kanë marrë pjesë nuk japin pothuajse asnje rekomandim se si mund të përmirësohet përshirja e tyre në kto dgejsa publike, si mund të rritet besimi i qytetarëve për një për një përfshirje dhe angazhim më të madh të tyre në këto procese.




Qytatarët e pyetur në lidhje me besimin në përmirësimin e vendimmarrjes përmes procedurave te Konsultimit Publik. Shumica e qytetarve që janë përgjigjur pyetësorit besojnë se procedurat e konsultimit publik mund të përmirësojnë vendimmarrjen. E megjithatë ka nga ato qytetarë që besojnë se vendimarrja nuk mund të përmirësohet duke u përfshirë ne proceset e konsultimit publik ahstu siç konstatojmë edhe një indifference nga pjesa tjetër e qytetarëve të cilët nuk japin asnjë përgjigje në lidhje me këtë pyetje. Rezultati i pyetësorit në lidhje me këtë pyetje tregon një perceptim mëse pozitiv mbi rëndësinë e këtyre procedurave por nga ana tjetër nënvizon nevojën për zbatimin e tyre më efektiv për të pasur rezultate konkrete.

# 10. Konkluzione dhe Rekomandime

**Konkluzione**

- Nga analizimi i procesit të konsultimit publik dhe transparencës në Bashkinë Vau Dejës, janë identifikuar disa gjetje dhe mundësi për përmirësim:
- Bashkia Vau Dejës ka krijuar një Rregjistër Elektronik të Projektakteve për Konsultim Publik, i cili centralizon dhe strukturon projektaktet dhe dokumentet në proces konsultimi.
- Në Bashkinë Vau Dejës asnjë person nuk mbulon pozicionin Koordinatorit për procesin e konsultimit publik, çka ndikon negativisht në menaxhimin e tij dhe në përputhshmërinë me kërkesat ligjore.
- Nuk është e mjaftueshme transparenca në publikimin e planeve vjetore të vendimmarrjes.
- Bashkia Vau Dejës ka një formë të standardizuar për njoftimet publike. Njoftimet bëhen në kategorinë "Njoftime" dhe jo në Programin e Transparencës.
- Në njoftimet mungon afati kohor për dërgimin e komenteve dhe rekomandimeve. Kjo çon në paqartësi dhe mungesë informacioni për qytetarët, duke ulur transparencën dhe pjesëmarrjen efektive në proceset e konsultimit publik.
- Mungon një regjistri mbi pjesëmarrjen e qytetarëve në konsultimet publike
- Informimi i pamjaftueshëm i qytetarëve, veçanërisht i të rinjve, rreth Ligjit për Konsultimin Publik. Megjithatë, ngritja e Këshillit Vendor Rinor na rrit besimin për rritjen e ndërgjegjësimin e të rinjve për tu përfshirë në këto procese.
- Mungesa e një sistemi të brendshëm monitorimi dhe vlerësimi për proceset e njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Vau Dejës e bën të vështirë identifikimin e pikave të dobëta në këtë proces.

**Rekomandime**

- Rekomandohet krijimi i një pozicioni të veçantë për Koordinatorin e Konsultimit Publik.
- Për të adresuar mungesën e njohurive mbi Ligjin për Konsultimin Publik, rekomandohet që Bashkia dhe Këshilli Bashkiak të organizojnë fushata informuese dhe edukative për qytetarët, sidomos me të rinjtë.
- Zhvillimi i pyetsorve online për të matur nivelin e kënaqësisë dhe besimit të qytetarëve në Proceset e Konsultimit Publik.
- Ngritjen një sistemi monitorimi dhe vlerësimi të brendshëm të Procesit të Njoftimit dhe konsultimit publik për të siguruar transparencë dhe pjesëmarrje të gjerë të qytetarëve.
- Për të përmirësuar transparencën rekomandohet publikimi i të gjitha planeve vjetore të vendimmarrjes në programin e transparencës.
- Krijimi i një regjistri të qartë dhe të përditësuar për pjesëmarrjen e qytetarëve në takimet dhe konsultimet publike.
- Zhvillimi i kanaleve dhe metodave të reja komunikimi për të rritur përfshirjen e qytetarëve dhe sigurimi që Proceset e Konsultimit Publik të jenë jo vetëm transparente, por edhe ndikueshme në vendimmarrje

# 11. Referenca (Lista e burimeve të përdorura për studimin)


- Ligji për Njoftimin dhe Konsultimin Publik: https://qbz.gov.al/eli/ligj/2014/10/30/146/3923aec7-2287-4909-9119-ea5dcee6245e
- Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" https://qbz.gov.al/eli/ligj/2015/12/17/139
- Ligjin Nr. 119/2014: Afatet për rishikimin e programit të transparencës https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/08/Ligj_119_2014_18.09.2014.pdf Faqe web POP: https://popnetwork.al/
- Raporti Studimor "Informimi, Njoftimi Dhe Konsultimi Publik" – BASHKIA Vau Dejës
- https://popnetwork.al/raporti-studimor-informimi-njoftimi-dhe-konsultimi-publik-bashkia-vau- i-dejes/
- Faqe web Bashkia Vau Dejës https://www.vaudejes.gov.al/historia-e-bashkise/
- Këshilli Bashkiak Vau Dejës https://www.vaudejes.gov.al/struktura-e-keshillit/
- Struktura organizative Bashkia Vau Dejës https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2024/04/STRUKTURA-2024.pdf
- Struktura e Këshillit Bashkiak Vau Dejës
- https://www.vaudejes.gov.al/struktura-e-keshillit/
- Vendim nr.69 , dt.29.09.2023 Për ngritjen e komisioneve të Këshillave Bashkiak https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2023/10/Vkb-nr.69-Shtator-2023.pdf Regullore të Këshillit Bashkiak Vau Dejës:
- https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/Rregullore-per-Keshillat-Bashkiake.pdf
- Rregullore e Këshillit Bashkiak Marrëdhëniet e Këshillit Bashkiak me Publikun dhe Median
- https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2020/04/Rregullore-e-keshillit-MARR%C3%8BDH%C3%8BNJET-ME-PUBLIKUN_Konsultim-DHE-MEDIAN.pdf
- Rregullore për Ngritjen, Funksionimin dhe Ndërveprimin e Strukturave Komunitare Në Bashki
- Rregullore e Këshillit Bashkiak Paraqitja dhe Shqyrtimi i Ankesave, Vërejtjeve, Kërkesave, Peticioneve dhe Iniciativave Qytetare
- Regjistrin elektronik, Bashkia Vau Dejës Rregjistri I kerkesave dhe ankesave:
- https://www.vaudejes.gov.al/rregjistri-ankese-kerkese-e-keshillit
- Rregjistri I projekt akteve per konsultim public
- https://www.vaudejes.gov.al/rregjistri-projekt-akteve-per-konsultim-publik-te-keshillit- bashkiak/
- Rregjistri I peticioneve dhe iniciativave qytetare
- https://www.vaudejes.gov.al/rregjistri-brendshem-peticioneve-dhe-iniciativave-qytetare/ Rregjistri për transparencën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak https://www.vaudejes.gov.al/rregjistri-mbledhjeve-te-keshillit-bashkiak/

- Formate , procedura, afate udhëzues https://www.vaudejes.gov.al/formate-procedura-afate-udhezues-2/
- Projektvendimet e projektakteve, Bashkia Vau Dejës https://www.vaudejes.gov.al/projekt-vendimet/ https://www.vaudejes.gov.al/vendimet-2024/
- Plani i aktiviteteve të Këshillit Bashkiak (janar-dhjetor 2024) https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2024/01/Vkb-nr.94-Dhjetor-2023.pdf Transparenca Bashkia Vau Dejës: https://www.vaudejes.gov.al/programi-i-transparences-2/ Pyetesor për përcaktimin e prioriteteve të komunitetit për vitin 2024
- https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSfny_ygEPuAbXDj5lqpBTMgWxhjUhkV1T5RJm- 4uei2zQaOWw/viewform
- Analiza e pyestori në lidhje me prioritetet e publikut për projektbuxhetin afatmesem 2024-2026
- https://docs.google.com/forms/d/e/1FAIpQLSfny_ygEPuAbXDj5lqpBTMgWxhjUhkV1T5RJm- 4uei2zQaOWw/viewform
- Raporte vjetore të Këshillit Bashkiak Vau Dejës. https://www.vaudejes.gov.al/raporti-vjetor-i-veprimtarise-se-keshilit-bashkiak/ Buxheti I Këshillit Bashkiak Vau Dejës
- https://www.vaudejes.gov.al/buxheti-i-keshillit-bashkiak/ Raporti I monitorimit të Bashkisë Vau Dejës janar -prill 2024
- https://www.vaudejes.gov.al/wp-content/uploads/2024/06/6.Bashkia-Vau-Dejes-Dergim- Raporti-Monitorimit-4mujori-i-pare-2024.pdf

## 12. Anekse

HAPA TË LEHTË

Nr.19 prot. Data 21/05/2024

**Lënda: Kërkesë për informim**

*Drejtuar:* **Z. Kristian Shkreli**, Kryetar i Bashkisë Vau Dejës

***I nderuar z. Kryetar,***

Shoqata Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë" si pjesë e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) https://popnetwork.al/ po realizon një studim për zbatimin e procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Vau Dejës për periudhën Shtator 2023 – Maj 2024.

**Përsa mësipër në bazë të nenit 3, të ligiit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", dhe nenit 17 te ligjit Nr. 146/2014 "Për njoftimin dhe konsultimin publik" kërkojmë të na informoni dhe dergoni:**

1) **Kopje të njoftimit për takime publike**

Duke mbetur në pritje të informacionit të kërkuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 15 të ligiit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të cilën mund ta dërgoni në adresën elektronike qendragruashk@yahoo.com

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

Denada Shpuza
Presidente e shoqatës

QENDRA E GRUAS HAPA TË LEHTË
Adresa:Gjuhadol, Rr.Murgeshave, nr.6, Shkodër
qendragruashk@yahoo.com

Adresa
Rruga e Murgeshave
Nr.6, Gjuhadol, Shkoder,
tel 022241316

Nr. 80 prot.

Data 22. 5. 2024

**Lënda: Kërkesë për informim**

*Drejtuar:* **Z. Kristian Shkreli**, Kryetar i Bashkisë Vau Dejës

***I nderuar z. Kryetar,***

Shoqata Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë" si pjesë e rrjetit Përballja e Ofertave Politike (POP) https://popnetwork.al/ po realizon një studim për zbatimin e procesit të Konsultimit Publik në Bashkinë Vau Djës për periudhën Shtator 2023 – Maj 2024.

**Përsa mësipër në bazë të nenit 3, të ligiit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", dhe nenit 18 te ligjit Nr. 146/2014 "Per njoftimin dhe konsultimin publik" kërkojmë të na informoni dhe të na dergoni:**

1) **Kopje te Procesverbaleve të takimeve publike të zhvilluara gjatë periudhes Shtator 2023 – Maj 2024**

Duke mbetur në pritje të informacionit të kërkuar brenda afatit ligjor të përcaktuar në pikën 1 të nenit 15 të ligiit Nr. 119/2014, "Për të drejtën e informimit", të cilën mund ta dërgoni në adresën elektronike qendragruashk@yahoo.com

